Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0750

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga;Isa Hasani-kryetar,duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) RED by Besa Security L.L.C., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Instalimi i sistemit të kamerave në Qendrën Korrektuese në Dubravë" me numër të prokurimit :33600-23-7047-5-2-1, me 09.01,2024, mori:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Operatorit Ekonomik, "RED by Besa Security" L.L.C. nr. 2023/0750, e datës 02/10/2023, kundër" Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" Autoriteti Kontraktues, Shërbimi Korrektues i Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Instalimi i sistemit të kamerave në Qendrën Korrektuese në Dubravë" me numër të prokurimit 33600-23-7047-5-2-1.

2. Mbetet në fuqi "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" datës, 14.09.2023, i Autoritetit Kontraktues, Shërbimi Korrektues i Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: 33600-23-7047-5-2-1.

3. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës ndaj Operatorit Ekonomik "RED by Besa Security" L.L.C , konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 12.07.2023, Shërbimi Korrektues i Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar ,Njoftimin për Kontratë B05, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi i sistemit të kamerave në Qendrën Korrektuese në Dubravë", numër të prokurimit; 33600-23-7047-5-2-1. Ndërsa me datën 14.09.2023 ka publikuar B58 ,Njoftimin Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka

shpërblyer me kontratë OE"Besa Security" L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.09.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 02.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE" RED by Besa Security" L.L.C., me nr. 750/23 lidhur me aktivitetin "Instalimi i sistemit të kamerave në Qendrën Korrektuese në Dubravë" me numër të prokurimit 33600-23-7047-5-2-1

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "RED by Besa Security" L.L.C.

Pretendimi i parë (I) Ankuesi pretendon se: "AK ka kërkuar format të kamerave bullet, kamera që janë më të mëdha, bien në sy më shumë si dhe vendosen kryesisht për të frikësuar/larguar keqbërësit dhe për t'ua bërë me dije se në atë vend ka kamera! Ndërsa, formati i ofruar nga OE i rekomanduar është format mini-bullet, që është kamerë më e vogël në madhësi, vërehet më vështirë, dhe kryesisht instalohet në vende më diskrete ku përdoruesit nuk dëshirojnë që kamerat të bijën në sy. Pra, AK po e lejon OE që të ofrojë produkte që nuk i përmbushin 100% specifikat teknike, në këtë rast po e favorizon këtë OE, duke rënë ndesh drejtpërdrejtë me Nenin 6 të LPP – Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi. Po ashtu, AK po vepron kundër Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik."

Pretendimi i dytë (II) Ankuesi pretendon se: "AK ka kërkuar Switch i cili është rack mount, kjo kërkesë përveç që është specifike, është edhe shumë e kjartë. Po ashtu, AK ka kërkuar edhe furnizim me rack 6U, pra, pajisjet janë të planifikuara që të instalohen brenda rack cabinetëve 6 unit. Ky instalim bëhet në formë horizontale. Njëjtë edhe më poshtë ku kërkohet pajisja UPS, kërkohet që edhe ajo të jetë rack mounted. Ndërsa, për këtë pikë OE ka ofertuar me switch që nuk montohet në rack, por montohet ne DIN rails. DIN rails janë rails metalike të standardizuara që përdoren zakonisht në ambiente industriale për instalimin e komponentëve të ndryshëm të kontrollit dhe automatizimit. Swichat që montohen në DIN rail janë kompakte dhe montohen në formë vertikale në kutia të siguresave, apo në panela të kontrollit ose enclosure boxes. Ndërsa, tani kushtimisht kërkesën që switchi të jetë rack-mount AK po e "largon" si kriter, duke thënë që montimi i switch mund të bëhet në rack apo kudo që është e nevojshme. Në raste të tilla, AK duhet ta precizoj që kjo është opcionale, mirëpo, në këtë rast, ka qenë specifikë e detyrueshme e cila duhet të përfillet 100% - gjë të cilën OE i cilësuar si i suksesshëm nuk e ka mbuluar"

Pretendimi i tretë (III) Ankuesi pretendon se: "Kabllot UTP (Unshielded Twisted Pair) CAT6 dhe CAT6e janë të dy lloje të kabllove Ethernet të përdorura për lidhjet e rrjetit, por ka dallime në specifikat dhe aftësitë e tyre të performancës. Kabllo e ofruar nga OE është e kategorisë CAT6, që ka bandwidth deri në 250 Mbit/s (ekuivalente 250 MHz), ndërsa AK ka kërkuar të kategorisë CAT6e që ka bandwidth deri në 500MHz. Po ashtu, AK ka kërkuar që konektorët të jenë RJ45 të metalit. OE nuk ka ofruar asnjë katalog ose fotografi të konektorëve që do të përdoren. Mirëpo, sipas AK, edhe pse kjo specifike nuk është përmbushur nga OE, kjo është në rregull pasi që nuk pengon në transferin e të dhënave. Pra, AK me

vetëdije të plotë nuk po vepron sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023. Po ashtu, edhe konektori që AK e ka cilësuar si pjesë përbërëse të kabllos – gjë që nuk qëndron pasi që konektori është pajisje komplet e ndarë, mirëpo vendoset në kabllo, OE nuk ka ofruar dëshmi që do të përdorë konektor të tillë me skelet metalik, gjë që duhet të shpie në eliminim direkt."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE "RED by Besa Security L.L.C.", konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 28 dhe 59 të LPP dhe shkeljet e dispozitave të Rregullores për Prokurim Publik duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 09/10/2023, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe me datën 10.10.2023, ekspertin teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 750/23, ndërsa me datë 20/10/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0750 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e OE "RED by Besa Security L.L.C"., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0750 ka vlerësuar:

Pretendimi i parë (I) ankimor është i pabazuar pasi që "Eksperti teknik pas shqyrtimit të specifikimeve teknike të detajuar në DT dhe dokumentacionit (katalogut) të paraqitur nga OE i rekomanduar për kontratën, arrin në përfundimin se ofertat e tyre përmbushin specifikat e kërkuara. Specifikacionet e kërkuara në DT përfshijnë formën "BULLET," rezolucionin 5MP, teknologjinë e ndriçimit të natës (IR), dhe natyrisht, që kamera të jetë antivandal. Nuk janë specifikuar detaje shtesë, si këndi i mbulimit, zona e instalimit, ose distancat e përdorimit. Duke pasur parasysh që DT nuk ka specifikuar të dhëna shtesë që do të mund të bënin ndryshimin midis një kamere "BULLET" dhe një kamere "MINI BULLET," eksperti teknik mendon që oferta e OE të rekomanduar përmbush kërkesat e specifikave teknike të dokumentacionit të tenderit."

Pretendimi i dytë (II) ankimor është i bazuar pasi që "eksperti teknik pas shqyrtimit të specifikimeve teknike të detajuara në DT dhe dokumentacionit të OE të rekomanduar, konfirmon se oferta përmbush kërkesat teknike të specifikave teknike të tenderit, përveç formës së kërkuar të pajisjes që të jetë "RACK MOUNT." Siç është kërkuar në DT, si do të jetë OE ka pasur mundësi që të e sqaron këtë cështje me anë të pyetjeve për sqarime shtesë."

Pretendimi i tretë (III) ankimor është i bazuar pasi që "eksperti teknik pas shqyrtimit të specifikimeve teknike të detajuara në DT dhe dokumentacionit të ofruesit të rekomanduar, kablloja e ofruar nga OE e rekomanduar nuk përputhet me specifikacionet e kërkuara në dokumentacionin e tenderit, pasi DT kërkon kabllo "UTP Cat6e." Ky ndryshim është teknikisht i rëndësishëm, pasi "Cat6e" është një standard më i avancuar dhe ka karakteristika të veçanta për të punuar me frekuencat më të larta dhe për të mbështetur

transmetimin me shpejtësi të lartë në distanca më të gjata(up to 100m), OE ka pasur mundësi që të e sqaron këtë çështje me anë të pyetjeve për sqarime shtesë. Gjithashtu, për sa i përket konektoreve RJ45 me skelet metalik, Me që është kërkuar të bëhet furnizimi dhe instalimi i të gjithë sistemit/pajisjeve dhe kabllove OE do të duhej të bënte terminimin e kabllove konfrom kërkesave të DT. Për këto arsye, eksperti teknik arrin në përfundimin se pretendimi i OE ankues në këtë çështje është i Bazuar dhe se oferta e OE të rekomanduar nuk përputhet plotësisht me specifikacionet e kërkuara në DT."

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit Ekonomik "RED by Besa Security L.L.C." , Njoftimin për Kontratë, i datës 12.07.2023, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 14.09.2023, Raportin e Vlerësimit Tenderëve i datës 07.08.2023,për aktivitetin e prokurimit "Instalimi i sistemit të kamerave në Qendrën Korrektuese në Dubravë" me numër të prokurimit 33600-23-7047-5-2-1, dhe Vendimin e |Autoritetit kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, i datës.22.09.2023.

Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur pjesërisht besimin e raportit të ekspertit, sipas të cilit nga tri pretendime ankimore, i pari është vlerësuar si i pabazuar, ndërsa pretendim dy i bazuar, por ne konstatimet është theksuar se nje pjese e kërkesave janë ne përputhje me kërkesat e DT ,eksperti thekson" ...konfirmon se oferta përmbush kërkesat teknike të specifikave teknike të tenderit, përveç formës së kërkuar të pajisjes që të jetë "RACK MOUNT." Siç është kërkuar në DT, si do të jetë OE ka pasur mundësi që të e sqaron këtë ceshtje me anë të pytjeve për sqarime shtesë",andaj per Panelin shqyrtues konstatimi i ekspertit se pretendimi ankimor dy i bazuar, është ne kundërshtim me vete përshkrimin te arsyetimit sipas te cilit

oferta përmbushë kërkesat teknike dhe specifike. Po ashtu edhe lidhur me pretendimin ankimor tre, qe ka te beje me pozicioni 4 - Furnizimi dhe shtrirja e kabllos UTP cat 6e, për kamerat IP si dhe terminimi me konektor RJ45 me skelet të metalit për çdo kamerë apo pikë, eksperti e ka konstatuar si te bazuar, ndërsa ne përshkrimin e arsyetimit thekson se kabelli i ofruar ka shpejtësi me te pakt ne raport me kabllin e kërkuar sipas DT, por Autoriteti kontraktues lidhur me çështjen e kabllit ne vendimin e tij, 22.09.2023, thekson se kablli i ofruar kapaciteti i tij shfrytëzohet nga kamerat vetëm deri ne 3% dhe se plotëson kërkesat dhe nevojat e tyre.

Paneli shqyrtues vëren se Autoriteti Kontraktues Shërbimi Korrektues i Kosovës, sipas vendimit te datës 22.09.2023, ne përgjigjen e dhëne OE ankues e ka argumentuar refuzimin e pretendimeve ankimore, te cilat janë bindës edhe për vete Panelin i cili i fale besimin e provës. Autoriteti i konstaton si devijime te vogla preformancat e furnizimeve nga OE i rekomanduar dhe plotësojnë kërkesat e saja nga ky aktivitet prokurimi. Vendimi i AK përgjigjja ne kërkesën per rishqyrtim te OE ankues "Sa i përket specifikave teknike ju sqarojmë se: 1. Ne kemi kërkuar kamerë bullet për instalim në ambiente të jashtme dhe dome për instalim në ambiente të brendshme. Me rëndësi është që kamera të ketë formën siq kemi kërkuar për instalim në ambient të caktuar. Ne, nuk kemi specifikuar dhe kufizuar dimenzionet apo madhësinë e kamerës, me rëndësi është që kamera e jashtme të jetë në formë bulleti dhe e brendshme në formë dome. Megjithatë, forma dhe madhësia e kamerës nuk afekton në karakteristikat teknike të kërkuara. Kamera posedon rezolucion 5MP, IR të integruar dhe është antivandale. 2. Switchi është kërkuar të jetë me 8 porte PoE dhe port SFP. Nga broshura e OE kemi konstatuar që switchi i ofertuar është për përdorim industrial me 8 porte PoE me kapacitet 10/100/1000Mbps (Gigabit) dhe 2 porte SFP me kapacitet Gigabit dhe plotëson kërkesat teknike andaj OE është i obliguar të bëjë montimin e tij në rack apo kudo që është e nevojshme gjatë instalimit. 3/4 3.Pas analizimit të broshurës së kabllit UTP CAT6 kemi konstatuar që ky kabëll ka brez frekuencor të funksionimit deri në 300MHz, dhe sipas gjerësisë së brezit, ky kabëll mund të mbështesë transferimin e të dhënave deri 250Mbps. Në rastin tonë, kamera e kërkuar është e rezolucionit 5MP, lëshimi i saj në punë me rezolucionin maksimal prej 5MP kërkon përafërsisht 7 deri 8Mbps, që i bie të shfrytëzoj vetëm 2.8% deri 3.2% të kapacitetit që ofron ky kabëll. Ne kemi kërkuar që të bëhet furnizimi dhe instalimi i sistemit, andaj operatori ekonomik e ka për obligim edhe terminimin e kabllove me konektor RJ45 me skelet metalik ashtu siç është kërkuar në Aneksin 1. Për më tepër, konektori është pozicion i përbërë në kërkesën e pozicionit të kabllos. Andaj, ne si komision kemi vlerësuar se të gjitha konstatimet sipas dispozitës ligjore LPP-së, neni. 59.4, "... autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë", AK e konsiderohen si devijim i vogël që nuk ndikojnë fare në kualietetin dhe përformancës e sistemit."

Paneli shqyrtues po ashtu vëren se ne Raportin e Vlerësimit te tenderëve te Autoritetit Kontraktues, i datës 07.08.2023, se kane ofertuar një numër prej shtate Operatoreve ekonomik, te cilët ofrojnë furnizime ne fushën e Teknologjisë Informative, për tregun e vendit e te cilët janë dhe ofertues ne shume raste te ofertave tenderuese, andaj dhe çdo vendim tjetër i marr nga Paneli nuk do te ndikonte që AK do te merrte oferta me furnizime tjera, por dhe vet AK e ka përzgjedhur OE te rekomanduar për kontrate, që plotëson kërkesat e saja sipas DT ne këtë aktivitet prokurimi.

Po ashtu Paneli shqyrtues vren se OE ankues, nuk ka arritur te argumentojnë me asnjë dëshmi se është i përgjegjshëm dhe ka plotësuar te gjitha kërkesat e Dosjes se tenderit, por vetëm ka akuzuar OE te rekomanduar lidhur me ofertën e tij tenderuese. Paneli shqyrtues vëren se Autoriteti kontraktues ne Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, te datës, 23.09.2023, ankuesin e ka vlerësuar si të papërgjegjshëm dhe e ka eliminuar nga procesi i prokurimit për shkaqe te kapaciteteve profesionale dhe teknike me

arsyetim si ne vijim" Oferta e juaj është e pa përgjegjshme në aspektin teknik, Nuk e keni përmbush specifikacionin teknik sepse nuk keni sjellur dëshmi për këto pika: Në piken nr. 1. mungon (kamerës se jashtme) specifika antivandal, dhe pika nr. 18 i mungon rezolucioni 4K sipas specifikes teknike te detyrueshme."

Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit, andaj Paneli përfundimisht ka vendosur për të refuzuar ankesën e Ekonomik "RED by Besa Security L.L.C." dhe mbetet në fuqi "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" datës, 02.10.2023, Shërbimi Korrektues i Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Instalimi i sistemit të kamerave në Qendrën Korrektuese në Dubravë" aktiviteti i prokurimit me numër;33600-23-7047-5-2-1.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të mbetet në fuqi i autoriteti kontraktues.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**
- OE - **RED by Besa Security L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: